

## Për një mbikëqyrje më efektive të tregut të sigurimeve

1 Gusht, 2014

### ENKELEDA SHEHI

Ligji për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit është një projekt i cili ka filluar të përgatitet që prej vitit 2008 dhe ka kaluar në një proces relativisht të gjatë diskutimi me institucionet kryesore në vend dhe palët e interesit. Procesi i



Kryetarja e AMF, Enkeleda Shehi

diskutimit të projektligjit ka zgjatur për më tepër se 2 vjet, nisur nga rëndësia dhe impakti që ky ligj ka në tregun e sigurimeve, gjë që u theksua dhe në raportin e FSAP, ku miratimi i ligjit për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit ishte pjesë e kushteve të DPL. Dy synimet kryesore të hartimit të ligjit të ri për sigurimet ishin: kalimi drejt mbikëqyrjes me fokus riskun, si dhe harmonizimi i mëtejshëm me direktivat e BE, si kërkesa të Komisionit Europian. Në mënyrë të veçantë në këtë ligj i kushtohet vëmendje mbrojtjes efektive të konsumatorit. Në ndryshim nga ligji ekzistues që përmbante vetëm dy nene në lidhje me kontratat e sigurimit, ligji i ri përfshin një kapitull të veçantë ku trajtohen në mënyrë të detajuar dhe të plotë parashikime në lidhje me detyrimin e sigurvearit për dhënien e informacionit të plotë e të qartë para nënshkrimit të kontratës së sigurimit dhe informimin e të sigurvearit gjatë gjithë afatit të vlefshmërisë së kontratës. Gjithashtu, parashikimet e dispozitave që lidhen me trajtimin e kërkesave për dëmshpërbim të konsumatorit përcaktojnë detyrimin e shoqërive të sigurimit për të trajtuar në kohë, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe transparente. Në ndryshim nga ligji ekzistues, ligji i ri sjell koncept të ri për personat kyçë dhe për kriteret që duhet të plotësojnë në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë, duke parashikuar se ata duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm profesionalisht dhe me integritet për të marrë përsipër këto role. Në këtë mënyrë, ligji ka synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së personave, të cilët administrojnë dhe drejtojnë shoqërinë e sigurimit. Në hartimin e dispozitave që lidhen me drejtimin e shoqërisë së sigurimit janë marrë parasysh edhe parimet e "qeverisjes së shoqërive (corporate governance)" të OECD-së. Forcimi i kërkesave për përshtatshmëri dhe aftësi të personave kyçë në shoqërinë e sigurimit, si dhe cilësia e menaxhimit buron nga metodologjia e mbikëqyrjes me fokus riskun dhe do të jetë element i rëndësishëm në vlerësimin e riskut nga ana e AMF. Seksioni IV i ligjit i është kushtuar grupeve, duke i mundësuar për herë të parë Autoritetit të ushtrorë mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi. Risia kryesore e këtij ligji është zhvendosja e mbikëqyrjes nga ajo e bazuar në rregulla, drejt mbikëqyrjes me fokus riskun. Kriza financiare botërore tregoi se institucionet rregullatore duhet t'i kushtojnë vëmendje trajtimit të

### Te lidhura



PD: Artur Bushi, një i inkriminuar që merr vulën e Bashkisë në lokale nate



Veza që di të bëjë Kryeministri

Mesha e parë në Shkodër... si fund dhe fillim

Reforma në Drejtësi: Ja njëra zgjidhje!



Dhuna ndaj bluzave të bardha, pacienti grushta infiermerit në Fier

riskut të sistemit, përveç risqeve individuale të operatorëve të tregut. Mbikëqyrja tradicionale bazuar në rregulla, ka rezultuar jo-efikase në parandalimin e vështirësive financiare për subjektet e mbikëqyrura. Kjo për vetë faktin se tregu financiar zhvillohet me një dinamikë të lartë, në kundërshtim me rregullat të cilat janë statike. Qëllimi i mbikëqyrjes me bazë riskun është të përqendrojë përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit financiar te menaxhimi i shoqërisë dhe këshilli mbikëqyrës. Koncepti bazë i mbikëqyrjes me bazë riskun është identifikimi dhe fokusi te risqet më të mëdha në veprimtarinë e një shoqërie sigurimi dhe më pas puna me menaxhimin e shoqërisë, me qëllim minimizimin e këtyre risqeve drejt niveleve të pranueshme. Objektiv i qasjes me bazë riskun është parandalimi i vështirësive financiare, përpara se ato të ndodhin, sesa tentativa për t'i rregulluar këto probleme pasi ato kanë ndodhur. Shoqëria e sigurimit duhet të ketë një sistem të administrimit të riskut për sinjalizimin dhe kontrollin që risqet të jenë brenda niveleve të përcaktuara në politikat e shoqërisë. Në këtë mënyrë, sistemi mbikëqyrës me bazë riskun jo vetëm që identifikon dhe mat risqet që lidhen me aktivitetin e një shoqërie sigurimi, por merr në konsideratë dhe deri në çfarë mase këto risqe minimizohen dhe administrohen nga proceset apo modelet e brendshme të shoqërisë. Tashmë AMF disponon një metodologji të mbikëqyrjes me fokus riskun, e cila do të fillojë të zbatohet gradualisht me hyrjen në fuqi të ligjit për sigurimet dhe risurimet dhe do të përbëjë bazën për ushtrimin e mbikëqyrjes me fokus riskun në operatorët e tregut. Si rrallëherë ky kuadër metodologjik ka qenë gati që prej vitit 2011 dhe zbatimi i tij ka pritur vetëm miratimin e ligjit për sigurimet. Ligji i ri shton kompetencat e Autoritetit që lidhen me ushtrimin e mbikëqyrjes me fokus riskun. Masat e mbikëqyrjes, sipas Seksionit V të ligjit mundësojnë që ndërhyrja të shpeshtohet dhe forcohet me rritjen e nivelit të riskut në një shoqëri sigurimi dhe për këtë arsye dhe masat janë hartuar në mënyrë të tillë që të lejojnë ndërhyrjen nga ana e Autoritetit dhe në raste apo situata dinamike, të cilat jo gjithmonë mund të listohen, por mund të paraqesin risk të lartë për shoqëritë e sigurimit apo konsumatorët. Një frymë e tillë po mishërohet në të gjitha praktikat rregullatore, si një përgjigje e natyrshme pas krizës financiare globale, e cila ekspozoi mangësinë e veprimit të autoriteteve mbikëqyrëse në situata të reja që lindën nga dinamika e zhvillimit të tregjeve financiare. Disa nga sfidat më të mëdha për t'u kapërcyer në këtë proces janë: Metodologji komplekse që kërkon aftësi profesionale të stafit mbikëqyrës – në një qasje me bazë riskun, stafi mbikëqyrës duhet të karakterizohet nga një shkallë e lartë integriteti, profesionalizmi dhe kuptimi të koncepteve financiare, risqeve dhe veprimtarisë së sigurimit dhe për më tepër të jetë në gjendje të diskutojë këto aspekte me anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe të menaxhimit të lartë të subjekteve të mbikëqyrura. Miratimi i ligjit të AMF përbën hap pozitiv në këtë drejtim dhe është shenjë e mirë e vullnetit politik, që bën të mundur kapërcimin e sfidave që lidhen me këtë proces, ndërkohë që miratimi i të gjithë paketës së AMF është thelbësor në mënyrë që të mos vihet në rrezik procesi i kalimit drejt një mbikëqyrjeje me fokus riskun. Gatishmëria e industrisë – shoqëritë e sigurimit duhet të krijojnë struktura të mirëfillta për administrimin e riskut. Në një ambient ideal, ku industria mban dhe zbaton modelet e saj të brendshme të administrimit të riskut, kalimi në një qasje me bazë riskun do të vinte në një mënyrë të natyrshme. Megjithatë, prezenca e investitorëve strategjikë në tregun shqiptar të sigurimeve, mund të lehtësojë disi këtë sfidë, nisur nga fakti që përfaqësojnë institucione të konsoliduara dhe të mbikëqyrura në tregje të zhvilluara ku mbikëqyrja me bazë riskun gjen zbatim, duke siguruar nivelin e nevojshëm të ekspertizës për subjektet ku ata kanë interesa pjesëmarrës dhe dominues. Në një pjesë të parakushteve Shqipëria ende është në tranzicion dhe kjo e bën zbatimin e mbikëqyrjes me fokus riskun edhe më sfidues. Kjo nuk duhet të pengojë fillimin e zbatimit gradual të kësaj metodologjie, duke i dhënë kohë dhe mundësi si tregut dhe Autoritetit të fitojnë

përvojën e duhur në këtë drejtim. Kalimi në një mbikëqyrje me bazë riskun është sfiduese për çdo rregullator sado i zhvilluar të jetë ai. Ajo që e zbut tranzicionin është vullneti i fortë i të gjithë aktorëve për të reformuar mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, duke hedhur kështu hapa të rëndësishëm drejt praktikave më të mira ndërkombëtare dhe integritimit në BE. Përtej sfidave që shoqërojnë këtë proces, disa nga avantazhet që zbatimi i kësaj metodologjie do të sjellë mund të listohen si më poshtë: Parandalimi dhe shmangia e problemeve – Një nga disavantazhet e mbikëqyrjes tradicionale e bazuar në rregulla është se problemet në shumicën e rasteve evidentohen kur mund të jetë tepër vonë për t'i eliminuar dhe, për rrjedhojë, mbikëqyrja mundohet të minimizojë pasojat. Mbikëqyrja me bazë riskun mundohet t'i evidentojë problemet dhe të reduktojë riskun, përpara se këto të kthehen në probleme serioze, pra synon parandalimin e problemeve dhe jo shërimin e pasojave. Administrim risku më i mirë dhe aftësi më të mira të mbajtjes së riskut – Qëllimi i mbikëqyrjes me bazë riskun është arritja e një niveli më të mirë të administrimit të riskut nga ana e subjekteve të mbikëqyrura, bazuar në praktika të shëndosha. Kur kjo gjë arrihet atëherë përfitimet i kalojnë dhe industrisë, si rezultat i shoqërive më eficiente dhe aftësive më të mira të administrimit të riskut. Efektet pozitive ekonomike në këtë rast janë të dukshme dhe në nivel makro, në sajë të një tregu më eficient. Përdorimi me efikasitet i burimeve – Duke qenë se burimet e mbikëqyrësve janë gjithmonë të kufizuara, energjia dhe fokusi më i madh i kushtohet problemeve dhe çështjeve me risk më të lartë dhe që mund të shkaktojnë më shumë dëm ndaj sistemit financiar. Mbikëqyrja me bazë riskun konsideron rolin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë, politikave dhe rregullave të brendshme si elementë të cilët, nëse ndiqen dhe zbatohen me rigorozitet nga menaxhimi, reduktojnë ndjeshëm shfaqjen e problemeve. Qasje e strukturuar dhe e qëndrueshme në vlerësimin e riskut – Pavarësisht faktit se mbikëqyrja me bazë riskun përdor gjykimin në një shkallë të lartë, një qasje e tillë mund të strukturohet në mënyrë që të jetë e qëndrueshme në vlerësimin e riskut nga ana e mbikëqyrësit. Metodologjitë e bazuara në risk, sigurojnë qëndrueshmëri në vlerësimin e riskut dhe vendimmarrje, nëpërmjet përdorimit të variablave të pranuar për matjen e riskut. Një pjesë e tyre mund të maten më me saktësi dhe t'i vendosen pesha specifike sipas rëndësisë, gjë që e bën metodologjinë e përdorur më pak të hapur ndaj gjykimit. Një gjë e tillë minimizon subjektivizmin që karakterizon interpretimet e ndryshme, në lidhje me një vlerësim apo një situatë të caktuar. Transparente për industrinë – Qëndrueshmëria, struktura dhe objektiviteti që karakterizojnë një sistem të tillë, rrisin transparencën për industrinë, duke qenë se, siguresit do të kenë akses se si maten dhe vlerësohen risqet nga ana e rregullatorit, përfshi këtu edhe veprimet që implikojnë ato, do të jenë në gjendje të gjejnë alternativa me risk më të ulët në arritjen e objektivave të tyre. Kalimi drejt një mbikëqyrje me bazë riskun në tregun e sigurimeve në Shqipëri është një sfidë e madhe dhe kërkon një Autoritet, që të zotërojë fuqi të plotë, mbrojtje ligjore dhe burime financiare të nevojshme për të ushtruar funksionet e tij (Parimi Nr 1 dhe 2, Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve). Pavarësia e Autoritetit, madje pavarësia reale e tij, është kushti i parë i domosdoshëm për alokimin e fondeve sipas mandatit, objektivave dhe risqeve. Së bashku me rekrutimin dhe mbajtjen e stafit me kapacitet të lartë profesional, do të jetë përcaktuese në suksesin e reformimit të sistemit mbikëqyrës si dhe kontribuimin në qëndrueshmërinë financiare dhe mbështetjen e zhvillimit të tregut të sigurimeve. **\*Kryetare e Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare**

